

Partneriteti i
Qeverisjes së
Hapur
Macedonia
e Veriut



MATERIAL EDUKATIV PËR PARTNERITETIN E QEVERISJES SË HAPU

Shkup, shtator 202



Partneriteti i
Qeverisjes së
Hapur
**Maqedonia
e Veriut**

MATERIAL EDUKATIV PËR PARTNERITETIN E QEVERISJES SË HAPU

Shkup, shtator 202

SI FILLOI PARTNERITETI I HAPUR QEVERTAR ?

Partneriteti i Qeverisjes së Hapur (PQH) është një iniciativë ndërkombëtare vullnetare e filluar nga tetë vende (Brazil, Indonezia, Meksiku, Norvegjia, Filipinet, Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) në vitin 2011. Maqedonia e Veriut iu bashkua kësaj iniciative menjëherë pas fillimit të saj. Sot në iniciativën marrin pjesë 78 shtete anëtare dhe një numër i madh i organizatave civile.

Duke iu bashkuar iniciativës, Qeveria e RMV-së nënshkroi një Deklaratë duke u obliguar së bashku me organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët për të përgatitur dhe zbatuar përpjekje konkrete për të paktën periudhë dy vjeçare për të promovuar transparencën, mbështetje të pjesëmarrjes civile, luftën kundër korrupsionit dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja në administratën publike dhe jashtë saj për mbështetje në inovacionet, etj.

Përveç procesit të PQH-së nga pushteti ekzekutiv, në vendin tonë të njëjtat procese realizohen edhe nga ana e pushtetit legjislativ (Parlamenti i hapur) dhe të pushtetit gjyqësor (Gjyqësori i hapur).

ÇFARË ËSHTË PARTNERITETI I QEVERISJES SË HAPUR DHE CILAT JANË PËRFITIMET E PËRFSHIRJES?¹

Qëllimi kryesor i PQH është të ndërtojë institucione publike që do të jenë transparente, që do të mundësojnë pjesëmarrje, të jenë të përgjegjshme dhe t'i përgjigjen nevojave të qytetarëve.

Përfitimi më i rëndësishëm nga iniciativa është obligimi i institucioneve publike gjatë përgatitjes dhe zbatimit të përpjekjeve për të promovuar transparencën, pjesëmarrjen civile, luftën kundër korrupsionit, etj., për të përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët dhe të bashkëpunojnë me ta. Kjo do të thotë, në vend që të krijojnë angazhime që bazohen vetëm në mendimet dhe pikëpamjet e tyre, ata kanë obligimin të flasin për reforma konkrete që plotësojnë nevojat e qytetarëve dhe kontribuojnë në përmirësimin e punës dhe hapjes së institucioneve publike.

Në institucionet publike dhe jashtë tyre ka njerëz që punojnë me këmbëngulje dhe përkushtim për të filluar reforma të caktuara, të cilat përmes proceseve të vendosura nuk identifikohen si të rëndësishme dhe nuk mund të realizohen. PQH ofron një mundësi për entuziastët nga institucionet publike dhe jashtë tyre të punojnë së bashku për të zbatuar ndryshimet.

Forca shtytëse e iniciativës është dhënia e rëndësisë parësore të qytetarëve. Përkatësisht,

“QYTETARET JANË ATA QË DUHET TË KRIJOJNË POLITIKAT DHE SHËRBIMET QË NDIKOJNË NË JETËN E TYRE.”

¹ <https://www.opengovpartnership.org/about/>




CILAT FUSHA PRIORITARE JANË ZGJIDHUR PËRMES PARTNERITETIT TË HAPUR QEVERITA?²

Deri tani, Qeveria e RMV-së ka miratuar katër, dhe ka zbatuar tre plane aksionale, me masa për të përmirësuar punën e Qeverisë dhe Institucioneve Publike (nga viti 2012 deri në vitin 2020 ç'do dy vjet).

Koordinatori i aktiviteteve qeveritare për PQH është Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), ndërsa organizatat e shoqërisë civile janë të përfshira në krijimin e Planeve Kombëtare Aksionale (PKA), si dhe në zbatimin e tyre.

Prioritetet për të cilat kanë punuar deri më tani institucionet publike dhe organizatat e e shoqërisë civile janë:



Prioritete



 Qasje në informata

 Të dhëna publike

 Qasje në drejtësi

 Integriteti dhe menaxhim i mirë

 Transparenca në nivelin lokal

 Ndryshimet klimatike

² <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership>

SI TË PËRFSHIHESH?³

Në procesin mund të përfshihen të gjithë që duan të japin kontribut të përkushtuar drejt ndryshimit të punës të sektorit publik dhe për të vendosur praktika të reja që kanë një ndikim pozitiv në jetën e qytetarëve.

Përfshirja është e thjeshtë dhe bëhet duke iu përgjigjur shtatë pyetjeve të shkurtra (informacione personale dhe kontakt informacione, fusha ku dëshironi të kontribuoni dhe cilat janë njohturitë tuaja për lëminë) në linkun në vijim:

NË PROCES MUND TË MARRIN PJESË DHE TË KONTRIBUOJNË TË GJITHË !



³ <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3029>



ME ÇFARË DINAMIKE ZBATOHET PROCESI?



PROCESI I KOORDINIMIT, BASHKË-KRIJIMIT DHE MONITORIMIT TË PROCESIT TË PHQ-së

1 RRJETI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR PARTNERITETIN E QEVERISJES SË HAPURO

Me iniciativën e dhjetë organizatave civile,⁴ u krijua një Rrjet i Organizatave të shoqërisë civile për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (PQH-së). Qëllimi kryesor i Rrjetit është të koordinojë dhe përforcojë zërin e organizatave të shoqërisë civile të cilët përpiqen për inicim, transparencë dhe llogaridhënie të autoriteteve. Rrjeti do të përpiqet për inicimin, inkurajimin, mbështetjen, zbatimin dhe monitorimin e procesit e PQH dhe për nxitjen e autoriteteve dhe institucioneve të tjera për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe transparencën e tyre të pjesëmarrjes (participim).

Rrjeti do të përpiqet të krijojë një strukturë të re për koordinimin e procesit PHQ në Maqedoninë e Veriut në përputhje me përvojën ndërkombëtare, në mënyrë që të përmirësojë komunikimin e të gjitha palëve të përfshira dhe të forcojë monitorimin dhe evaulimin e aktiviteteve. Rrjeti do të marrë pjesë dhe do të kontribuojë në krijimin e një strukture të re për koordinimin dhe monitorimin e zhvillimit dhe zbatimit të PNA-ve.

⁴ Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave (ESE), Shkup; Shoqata për Promovimin dhe Zhvillimin e Shoqërisë Gjithëpërfshirëse - INKLUZIVA; Qendra për Menaxhimin me Ndryshimet (QMN); Shoqata për kërkime, komunikime dhe zhvillim "Pablik"; Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS); Shoqata e Qytetarëve Qendra për komunikime civile SHKC Shkup; Fondacioni i Shoqërisë së Hapur - Maqedoni; Reaktori - Kërkime në aksion; e Shoqata e Qytetarëve Mirësia; Fondacioni Metamorfozis.



Pse Rrjeti i organizatave civile dhe cili do të jetë roli i tij?

Rrjeti i organizatave civile për partneritet të hapur qeveritar është formuar në vigjilje të përgatitjes së planit të ri kombëtar të veprimit (të pestë), me qëllim një veprim dhe ndikim më të organizuar të organizatave të shoqërisë civile në krijimin e tij, si dhe inkurajimin dhe monitorimin e zbatimit të planeve ekzistuese dhe të ardhshme aksionale . Roli i rrjetit është të mobilizojë dhe koordinojë avokimin e shoqërisë civile për çështjet e PQH-së.

Qëllimet e Rrjetit

Qëllimi kryesor i Rrjetit është të koordinojë dhe forcojë zërin e organizatave civile të cilat punojnë për pjesëmarrjen, hapjen dhe llogaridhënien e autoriteteve. Rrjeti do të përpiqet për inicim, inkurajim, mbështetje, zbatim dhe monitorimin e procesit të PQH-së dhe të bëjë presion mbi autoritetet dhe institucionet e tjera për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe transparencën e tyre të pjesëmarrjes (participim). Rrjeti do të përpiqet të krijojë një strukturë të re për koordinimin e procesit të PQH -së në Maqedoninë së Veriut në përputhje me përvojën ndërkombëtare, në mënyrë që të përmirësojë komunikimin të të gjitha palëve të përfshira dhe të forcojë monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve.

Rrjeti do të marrë pjesë dhe do të kontribuojë për zhvillimin e një sktrukture të re për koordinimin dhe monitorimin e zhvillimit dhe zbatimit të PKV-së. Struktura e re duhet duhet të mbindëtojë praktikën ekzistuese dhe të resurseve të angazhuara në PQH.

Rrjeti duhet të inkurajojë dhe të rrisë përkushtimin e palëve të interesuara për zhvillimin e PKV-së përmes procesit që përfshin të gjitha palët, me përfshirjen aktive të qytetarëve dhe shoqërisë civile.

2 KËSHILLI PËR KOORDINIMIN DHE PËRCJELLEN E PROCESIT TË PARTNERITETIT TË HAPUR QEVERITAR DHE PNA-ve PËR PHQ-it

Më 6 maj u mbajt video seanca konstituive e Këshillit mbi Koordinimin dhe Përcjelljen e Procesit të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (PQH) dhe Planit aksional nacional të PHQ-të 2018-2020 (Këshilli). Në seancë u zyrtarizua konstituti i Këshillit si trup këshilldhënës i PQH-së së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për koordinimin dhe Përcjelljen e zhvillimit dhe realizimit të planeve aksionale (PA).

Këshilli ka një rol të rëndësishëm dhe në një mënyrë të strukturuar do të maksimalizojë pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin midis institucioneve dhe shoqërisë civile, duke përfshirë partnerët përkatës në diskutim dhe duke mundësuar që zërat e të gjithëve të dëgjohen.

Këshilli ka një rol të rëndësishëm këshilldhënës dhe rol vendimtar në të gjitha fazat e procesit të PQH-së në ciklin e planifikimit, në zhvillimin e PA-së dhe në realizimin, përcjelljen dhe raportimin për PA-në.

Këshilli u formua me qëllim që të nxitet transparenca dhe hapja e punës së organeve të administratës shtetërore dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në realizimin dhe ndjekjen e iniciativës së PHQ-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të sigurojë bashkëpunim ndërsektorial dhe të vendosen mekanizma të qarta, të strukturuar dhe afatgjate për dialog të përhershëm ndërmjet autoriteteve dhe shoqërisë civile; të rritet pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e PHQ-së në përgatitjen e planeve aksionale të PHQ-së dhe për mbështetjen, nxitjen dhe përcjelljen e realizimit të planit aksional aktual.



Këshilli është përbërë prej 14 anëtarëve me numër të barabartë të institucioneve dhe të shoqërisë civile dhe është udhëhequr nga një përfaqësues i organeve të administratës shtetërore dhe nga një përfaqësues i zgjedhur nga organizatat civile (dy bashkëkryetarë), i cili do të jetë modeli i parë i tillë i partneritetit dhe barazisë në vendimarrje në shtetin tonë. Në periudhën në vijim, pritet intensifikimi i aktiviteteve lidhur me realizimin e PA-së aktuale, por edhe i përcaktimit të kornizës së re kohore dhe përcaktimit të prioriteteve që paraprijnë në bashkëkrijimin e PA-it të ri të pestë, ku roli kyç dhe kontribut pritet nga Këshilli.

VEGLA PËR ZBATIMIN E ONLINE KONSULTIMEVE – PLATFORMA (PORTALI UEB) PËR PARTNERITETIT TË HAPUR QEVERTAR

Krijimi i platformës së internetit do të përdoret për informimin, konsultimet, monitorimin dhe shkëmbimin e njohurive midis të gjitha palëve të përfshira në PQH-në institucionet, organizatat e shoqërisë civile, qytetarët, Këshillin, Rrjetin dhe në të njëjtën kohë do të ofrojë vegla të internetit për komunikim dhe koordinim në zhvillimin e AP-it të ri. 2021-2023.

SHEMBUJ TË PËRFITIMEVE TË KËSAJ INICIATIVE NË VITET E FUNDIT?

Në Liberi, Qeveria i edukon dhe i ndihmon qytetarëve të mbrojnë pronën e tyre dhe të sigurojnë jetesën e tyre.

Në Mongoli, me anë të përparimit të llogaridhënies së Qeverisë po përparojnë rezultatet në fushat e shëndetësisë dhe arsimit.

Në Kosta Rikë, Qeveria punon me qytetarët për të identifikuar dhe tejkaluar ndikimet negative të politikave mbi ta.

Në Maqedoninë e Veriut, duke i hapur të dhënat nga transaksionet e thesarit në nivel nacional dhe lokal, Qeveria mundëson një pasqyrë më të madhe të shpenzimeve të sektorit publik që do të ndikojë në uljen e korrupsionit dhe të shpenzimeve joefikase, dhe për herë të parë në PV 2018-2020 përfshihet prioriteti i ri, Aksesi në drejtësi, me 2 angazhime, duke e bërë vendin tonë të vetmen në rajon.



„Materiali edukativ i Partneritetit të qeverisjes së hapur“ është përgatitur nga nëngrupi i punës i formuar në kuadër të Këshillit për koordinimin dhe monitorimin e procesit të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur dhe Planit Nacional Aksional për Partneritet të Qeverisjes së Hapur 2018 - 2020, i përbërë nga: Gordana Gapiq Dimitrovska, Nadica Josifovski, Eli Çakar, Darko Antiq dhe Ivona Stalevska

